



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 23/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, me seli në Ferizaj, kundër debitorit DPH “A....A”, me seli në fshatin ..., Komuna e Lipjanit, me pronar B.Z. , duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.91/2015 të datës 06.01.2015, të Përmbartuesit Privat Arben Gashi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 14.11.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit DPH “A....A”, me seli në fshatin ..., Komuna e Lipjanit, me pronar B.Z. , SHFUQIZOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.91/2015, i datës 06.01.2015, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Arben Gashi, për pjesën e kamatës ligjore prej datës 24.11.2014, e deri në pagesën definitive.

II.MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.91/2015, i datës 06.01.2015, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Arben Gashi, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 2500.00 €.

III.PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, me seli në Ferizaj, ndaj debitorit DPH “A....A”, me seli në fshatin ..., Komuna e Lipjanit, me pronar B.Z. , sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr. 91/2015 të datës 06.01.2015, të Përmbartuesit Privat Arben Gashi, për pjesën e kamatës ligjore prej datës 24.11.2014, e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Kreditori, Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, me seli në Ferizaj ka parashtruar propozim për përmbaerim kundër debitorit DPH “A...A”, me seli në fshatin ..., Komuna e Lipjanit, me pronar B.Z. , për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbaerues – Aktvendimi i Trupit Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, nr. 352/2014, të datës 24.11.2014, me të cilin debitori është obliguar që kreditorit në emër të masës ndëshkimore-gjobës, t’ia paguaj shumën prej 2500.00 €, me kamatë ligjore prej datës 24.11.2014 e deri në pagesën definitive.

Përmbaeruesi Arben Gashi, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, me seli në Ferizaj, me datë 06.01.2015, ka lëshuar Urdhrin Përmbaerimor P.nr.91/2015, me të cilin ka lejuar përmbaerimin në bazë të dokumentit përmbaerues, Aktvendimi i Trupit Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, nr. 352/2014, të datës 24.11.2014, me të cilin është detyruar debitori që në emër të masës ndëshkimore t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2500.00 € , me kamatë vjetore prej datës 24.11.2014, ndërsa realizimi të behet ashtu që të ndalohet qarkullimi i mjeteve në xhirollogarinë e debitorit dhe llogarive tjera ndihmëse në BPK si dhe sekuestrimi i sendeve me vlerë gjerë në bartjen e shumës së cekur në xhirollogarinë e kreditorit.

Debitori DPH “A...A”, me seli në fshatin ..., Komuna e Lipjanit, me pronar B.Z. , brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me shkrim, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit e procedurës kontestimore, për shkak se urdhëri është i pa përshtatshëm për ekzekutim dhe ka cenuar dinjitetin e debitorit. I ka propozuar gjykatës që procedura përmbaerimore të ndërpritet dhe të refuzohet urdhri përmbaerimor si i pabazuar.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka deklaruar se prapësimi është i pabazuar dhe i ka propozuar gjykatës që i njëjti të refuzohet. Në lidhje me pretendimet e debitorit se ka parashtruar padi dhe ka iniciuar konfliktin administrativ, ka deklaruar se pretendimi i tillë është i pabazuar, sepse sipas nenit 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative, padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ. Tutje ka shtuar se kreditori propozimin për përmbaerim e ka parashtruar duke u bazuar në aktvendimin e nxjerrë në procedurë administrative i cili është i ekzekutueshëm dhe sipas nenit 22 të LPP-së përbën titull ekzekutiv dhe si i tillë propozimi për përmbaerim i

parashtruar nga kreditori i plotëson të gjitha kushtet dhe është i përshtatshëm për përmbarrim sipas nenit 23 par.2 dhe nenit 24 par.1 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarrues ka lejuar përmbarrimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarrimor, përkatësisht Aktvendimi i Trupit Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, nr. 352/2014, të datës 24.11.2014, në bazë të së cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarrues sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu vendimi, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbarrjes së detyrimit”,* pasi që janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, objekti si dhe shuma e cila është detyrim për përmbarrje nga ana e debitorit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi i Trupit Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës, nr. 352/2014, të datës 24.11.2014, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmërisë për përmbarrueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit

përcaktohet se: “Vërtetimin për përmbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti ka parashtruar padi për hapjen e konfliktit administrativ mirëpo gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore ngase në nenin 22 të Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, është përcaktuar se: “Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”. Andaj fakti se debitori ka parashtruar padi nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbarimore.

Gjykata ka shqyrtuar urdhrin përmbarimor P.nr.91/2015 të datës 06.01.2015, të Përmbaruesit Privat Arben Gashi, sa i përket pjesës së obligimit të debitorit për pagesën e kamatës së përcaktuar me urdhrin përmbarimor, mirëpo konstatoi se me dokumentin përmbarimor sipas të cilit është lëshuar urdhri për përmbarim, debitori është obliguar që në emër të masës ndëshkimore t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2500.00 €, mirëpo jo edhe kamatën ligjore, dhe si i tillë urdhri përmbarimor nuk është në përputhje me dokumentin përmbarimor, andaj gjykata të njëjtin e shfuqizoi pjesërisht vetëm sa i përket pjesës së kamatës së kërkuar.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.23/22, datë 14.11.2022

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.